



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA

EKSTRAKT

nga procesverbali i mbajtur më 26 maj 2014, në mbledhjen e IV-të (katërt) të jashtëzakonshme Komitetit për Politikë dhe Financa.

Mbledhja u mbajt në sallën nr. 31 dhe filloi në orën 13.10'.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z. Mehmet Gashi, kryesues i Kuvendit, përkatësisht kryesues i këtij Komiteti.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e këtij Komiteti, përkatësisht Afrim Shabani, Bahri Blakçori, z. Islam Revuci Fidan Rekaliu, Haki Rudari, Kadri Avdiu, Kumrie Hoti, Mynavere Abdullhau – Krasniqi, Naim Çunaku dhe Rafet Llapashtica.

Me këtë konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimarrje.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe z. Agron Hyseni, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, z. Faik Muçiqi, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit, z. Abaz Llugaliu, drejtor i Drejtorisë së Pronës, Kadastrit dhe Gjeodezisë dhe z. Muharrem Haziri, përfaqësues i OSBE-së.

1. Miratimi i rendit të ditës

z. **Kadri Avdiu**, theksoi, pasi e kam marrë thirrjen dhe materialin për këtë mbledhje e vërejta se nuk është një pikë e rendit të ditës për të cilën jemi marrë vesh e kjo ka të bëjë me çështjen e zgjërimit të lokacionit për ndërtimin e obeliskut për Dëshmorin Afrim Zhitia, çështje e cila është duke u vonuar mjftë shumë.

z. **Mehmet Gashi**, kryesues, theksoi, në mbledhjen e jashtëzakonshme të KPF – së të mbajtur më 15 prill 2014, e kemi shqyrtuar vetëm çështjen të cilën e ngriti parafolësi dhe në mënyrë unanime jemi pajtuar se fillimisht duhet të respektohet afati për parashtrimin e ankesave të personave të cilët me aktvendime të shkallës së parë është konstatuar se e kanë uzurpuar tokën në pronësi të Komunës dhe se pas plotfushmërisë të aktvendimeve kjo çështje do të shqyrtohet në KPF përkatësisht Kuvend të Komunës.

z. **Haki Rudari**, propozoi që në rend dite të përfshihet edhe Informata për mbjelljet pranverore, material të cilin duhet ta përgatit Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Gjithashtu jam në dijeni se janë duke u dhënë subvencione në kategori të ndryshme, mirëpo ne nuk kemi informacione se në bazë të çfarë kriteresh bëhen

subvencionimet dhe si vijon ky proces, andaj për këto çështje kërkoj që të përgatiten informatat përkatëse.

z. **Mehmet Gashi**, kryesues, theksoi, për çështjet të cilat i ngriti parafolësi ne mundemi të rekomandojmë që informatat përkatëse të përgatiten për mbledhjen e radhës, ngase ato informata nuk ka mundësi të përgatiten për mbledhjen e nesërme të Kuvendit.

Rendi i propozuar i ditës u miratua me shumicë votash, përkatësisht 6 vota për dhe 4 vota kundër.

2. Informatë për vërvshimet, aktivitetet e ndërmarra si dhe dëmet e shkaktuara nga vërvshimet, në periudhën prill – maj 2014

z. **Faik Muçiqi**, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit, e paraqiti fjalën hyrëse.

z. **Kadri Avdiu**, theksoi, në këtë informatë, përveç tjerash, përmendet që Komisioni ka konstatuar se shtëpia e familjes Kuleta në Tërrnavë paraqet rrezikshmëri për atë familje, gjithashtu është kërkuar edhe largimi i disa familjeve në Bellopojë për shkak të rrezikshmërisë nga vërvshimet, mirëpo sipas mendimit tim nuk mjafton që në terren të del vetëm komisioni përkatës apo zjarrëfiksit por është dashtë të del edhe stafi politik që në realitet e ka përgjegjësinë më të madhe, ngase prezenca e tyre do të ndikonte mjaft tek qytetarët, andaj kjo është një vërejtje e imja.

Vërejtja e dytë është se në menaxhimin e buxhetit është duke u bërë një gabim i madh ngase sikur të ishte bërë zgjerimi i shtretërve të lumenjve, që kemi kërkuar shumë herë, nuk do të ndodhnin dëme e as shpenzime kaq të mëdha në bujqësi dhe ekonomi familjare.

Shtretërit e lumenjve, jo që janë ngushtuar por e kanë humbur edhe kuptimin e vet. Vitin e kaluar ka qenë një rast në Bellopojë që është bërë ndryshimi i rrjedhës ku shtrati i lumbit sipas elaboratit kadastral është 25 m. tash në realitet është afro 0.5 m. andaj shtrohet pyetja përse Drejtoria kompetente nuk ndërmerr asnjë veprim.

Edhe një herë e ngris shqetësimin tim për familjen e Xhevav Kuletës dhe kërkoj që Ekzekutivi i Komunës të ketë kujdes për këtë rast dhe i përmenduri të përfshihet në prioritet për ndërtimin e shtëpisë ngase ai i ka 7 fëmijë dhe është në gjendje sociale shumë të rëndë.

z. **Rafet Llapashtica**, theksoi, po ndërlidhem me një pikë tjeter që është në rend dite, përkatësisht Planin e punës të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi dhe lidhur me këtë jam i mendimit se është përgjegjësi e Ekzekutivit që këtë Plan nuk e ka paraqitur me kohë për shqyrtim por këtë e bënë pas pesë muajve ngase sikur të ishte miratuar më parë ky dokument drejtoria përkatëse do të menaxhonte më lehtë situatën e krijuar nga vërvshimet.

Nga materiali vërejta se vitin e kaluar janë ndërtuar rrjete të kanalizimit dhe gjatë vërvshimeve kanë ndodhur defekte të cilat kanë paraqitur vështirësi dhe do të paraqesin edhe në të ardhmen.

Në informatë thuhet se është angazhuar një kompani, mirëpo bazuar në situatën e krijuar me qëllim të parandalimit dhe evitimit të pasojave nga vërvshimet është dashur të angazhohen një numër më i madh i kompanive ngase sikur të veprohej

në këtë mënyrë sigurisht dëmet do të ishin më të vogla, andaj konsideroj se menaximi nuk ka qenë efikas, mund të them edhe jo profesional.

z. Fidan Rekaliu, theksoi, në fjalën hyrëse u sqarua se porsa kanë filluar vërshimet të gjitha strukturat kompetente të Komunës kanë dal në terren dhe sipas mundësive i kanë ndërmarrë të gjitha veprimet e mundshme.

Vërshimet nuk varen nga ne por në këtë aspekt edhe ne ndikojmë në përkeqësimin e situatës ngase jemi dëshmitarë sa janë ngushtuar shtretërit e lumenjve e këtë gjendje e rëndon edhe hedhja e mbeturinave të ndryshme, por fatmirësishët është rregulluar një pjesë e shtratit të lumi Llapi e kjo ka ndikuar që të mos ketë vërshime në qytet.

z. Naim Çunaku, theksoi, konsideroj se në këtë Informatë, në vija të trasha, janë pasqyruar aktivitetet e Komunës tonë gjatë vërshimeve, mirëpo vërejtjet e mia konsistojnë në atë se situata çfarë ka qenë në Komunën tonë është dashtë që Kuvendi i Komunës të mbaj një mbledhje urgjente, ngase ka qenë një situatë jo e zakonshme.

Kjo Informatë, sidomos, na njofton për aktivitetet e Komunës por shtrohet pyetja, çka do të ndërmerret me sanimin e dëmeve të shkaktuara nga vërshimet, pra shtrohet pyetja, një udhëheqësi komunale a është për ta konstatuar një situatë apo duhet ta shtri aktivitetin e vet me menaxhuar situatën si dhe për të ofruar kompensimin e dëmeve dhe evitimin e rreziqeve për të ardhmen.

Kur e kemi shqyrtuar projektbuxhetin, në foltoren e Kuvendit, kam thënë se komuna duhet ta ketë një fond për situata emergjente përkatësisht për raste të fatkeqësive elementare.

Shumë pjesë që i kanë përfshirë vërshimet kanë qenë burim potencial për infektim të qytetarëve, andaj do duhej të bëhej Dezinfektimi, Derratizimi dhe Dazinsektimi. Drejtori, në fjalën hyrëse, e përmendi vetëdijesimin e qytetarëve, lidhur me këtë jam i mendimit se qytetarët e pandërgjegjshëm më së tepërm i vetëdijosjnë masat ndëshkuese ngase nuk është në rregull që për shkak të ndonjë të pandërgjegjshmi që uzurpon pronën e Komunës, të pësojnë të tjerët.

Jam i mendimit se prioritet i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale duhet të jetë hartimi i një plani që në pjesët ku pasur vërshime të bëhet DDD-ja.

z. Afrim Shabani, theksoi, me vëmendje e kam lexuar këtë Informatë e në veçanti masat të cilat duhet të ndërmerren në rastet e vërshimeve, dihet ne nuk mund t'i ndalim fatkeqësitë natyrore, mirëpo mund të zhvillojmë aktivitete për zgjerimin e shtretërve të lumenjve dhe largimin e mbeturinave të ndryshme në të gjitha vendet ku pengohet rrjedha normale e ujit, por njëkohshisht mund të ndikojmë edhe në marrjen e masave ndëshkuese ndaj keqbërsëve të cilët uzurpojnë pronat ku kalojnë lumenjtë.

Pajtohem me mendimin e z. Kadri Avdiut, se çështja e familjes Kuleta të cilës i është dëmtuar shtëpia nga vërshimet, duhet të merret me seriozitetin më të madh.

z. Haki Rudari, theksoi, gjatë kohës së vërshimeve kam dal në terren dhe atë nga Repa deri në Lupç dhe e kam parë gjendjen e krijuar, mirëpo vërehet një diskrepancë në mes të asaj çfarë thuhet nga qytetarët dhe asaj që thuhet në Informatë, konkretisht në Informatë thuhet, Komisioni për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore ka dal në vendin e ngjarjes, por unë kam dëgjuar shumë ankesa nga qytetarët se Komisioni nuk ka dal në terren e disa prej ankesave janë nga fshatrat Siboc, Lupç e vende të tjera.

Gjatë debatit u përmend se fatkeqësitet natyrore ndodhin kudo, mirëpo te ne shkaku i vërshimeve kryesisht është ngushtimi i shtretërve të lumenjve, pra nuk është fajtor faktori natyror por fajtor është faktori njeri, mirëpo njëkohësisht fajtor është edhe Ekzekutivi i Komunës përkatësisht Drejtoritë kompetente.

z. Kadri Avdiu, theksoi, kjo qeverisje komunale në momente të caktuara duhet të thërras mbledhje urgjente të Kuvendit ngase qytetari duhet të sheh se ne nuk nuk i ikim përgjegjësive.

Ne duhet të ndajmë mjete buxhetore për zgjerimin e shtretërve, kjo duhet bërë pa diskutim, gjithashtu duhet ta kemi të qartë se shteti duhet të funksionoj, jo vetëm që çështjet t'i konstatoj në letër por të veproj praktikisht, pra Drejtoria e Pronës, Kadastrit dhe Gjeodezisë duhet të ndërmerr të gjitha masat ligjore ndaj uzrpuesve të pronës së Komunës.

Një rast konkret është lumi që vjen prej Dyzi, ne i themi lumi i Tërrnavës, i cili është bllokuar andaj shtrati i atij lumi duhet të pastrohet në mënyrë që afro 30 shtëpi të mos bllokohen në raste të vërshimeve.

Pas votimit u konstatua se informata, Kuvendit njëzëri i rekomandohet për shqyrtim, me sugjerime që:

- Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëgenies Sociale të merr parasysh gjendjen e Familjes Kuleta në fshatin Tërrnavë të cilës nga vërshimet i është dëmtuar shtëpia.
- Në prioritete, për periudhën e ardhshme, të përfshihet zgjerimi dhe rregullimi i shtretërve të lumenjve dhe prrockave
- Të ndërmerren masa ndaj të gjithë atyre të cilët kanë uzruuar paluajtshmëritë e shtretërve të lumenjve dhe përroskave si dhe atyre të cilët hedhin mbeturina në lumenj.
- Të bëhet derratizimi, dezinsektimi dhe dezinfektimi afër shtretërve të lumenjve ku paraqitet nevoja.

3. Propozimi i Rregullores për caktimin e kritereve për dhënien e shtëpive në pronësi të Komunës në shfrytëzim në lagjen e Dëshmorëve në fshatin Balloç

z. Agron Hyseni, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëgenies Sociale, e paraqiti fjalën hyrëse.

z. Haki Rudari, theksoi, Komisioni për ndarjen e shtëpive në Lagjen e Dëshmorëve, anëtar i të cilët jam, e ka shqyrtau propozimin e kësaj Rregulloreje dhe atë ditë na është thënë se në lagjen e cekur janë 120 familje, ndërsa sot drejtori në fjalën tha se janë 131 familje. Gjithashtu vërejtje kam pasur në propozimin e Rregullores aty ku thuhet, banes i lagjes, ngase sipas mendimit tim përfituese mund të jetë familja me status të banuesit aktual.

z. Rafet Llapashtica, theksoi, jemi në dijeni se lagjja e Kuvajtit, tash lagjja e Dëshmorëve, menjëherë pas lufte është ndërtuar për familjet e dëshmorëve, familjet të cilat i kanë humbur prindërit dhe familjet e pastrehë. Sigurisht ekziston dokumentacioni i banuesve në atë lagje, mirëpo jam i mendimit se përfitues i

shtëpisë nuk mund të jetë ndonjë familje e cila ka qenë përfituese e donacioneve në programin e rindërtimit të shtëpive të shkatërruara gjatë luftës.

Komisioni duhet të ketë kujdes se cilat familje me status të banuesit të lagjes do t'i vendos nëpër shtëpitë e ndërtuara në fazën e parë e pastaj edhe në shtëpitë e të cilat do të ndërtohen në fazat tjera.

z. Afrim Shabani, theksoi, neni 3 i propozimit të Rregullores përcakton në mënyrë të qartë se shtëpitë e dhëna në shfrytëzim janë aset i Komunës se nuk mund të jepen me qira dhe se nuk mund të shfrytëzohen për destinim tjetër, përvèç banimit. Gjithashtu neni 4 përcakton se përfitues i shfrytëzimit të shtëpive mund të jetë vetëm familja me status të banuesit të lagjes.

z. Naim Çunaku, theksoi, ne e kemi vetëm propozimin e Rregullores, mirëpo do të ishte mirë që së paku para mbledhjes së Kuvendit të na jepet edhe Memorandumi i lidhur në mes të Komunës dhe Ministrisë së Punës dhe mirëqenies Sociale, ngase ne nuk jemi në dijeni se çfarë përmban Memorandumi i cekur.

Kur Kuvendi i Komunës ka marrë vendim për ndarjen e këtij lokacioni i ka pasur disa kritere dhe ai vendim duhet të jetë bazë i kësaj çështjeje, në këtë kontekst propozoj që në nenin 4 ku flitet për përfituesit t'i shtohet, prioritet kanë familjet e dëshmorëve. Në nenin 5 nuk e kuptoj se çfarë do të thotë, Familje në përkujdesje të fëmijëve, e që do duhej të jetë, Familje me fëmijë pa prindër., në nenin 7ku thuhet, Familjet që posedojnë troje, t'i shtohet, jashtë lagjes.

Në nenin 10, para fjalisë, rekomandon për largimin e objekteve aktuale, duhet t'i shtohet, Drejtorisë përkatëse, në mënyrë që të konkretizohet se kujt i rekandomohet largimi i objekteve aktuale të banimit.

Gjithashtu jam i mendimit se duhet shqyrtuar nenin 11 ku thuhet, ata që nuk pajtohen me listën e Komisionit, mund t'i parashtronë ankesë Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, këtë e them ngase edhe Komisionin edhe Komitetin e cekur i ka ngritur Kuvendi, mirëpo për këtë të fundit nëse pajtoheni me formulimin e shkruar në propozimin e Rregullores, as unë nuk jam kundër.

z. Kadri Avdiu, theksoi, shtëpitë e planikuara për ndërtim në fazën e parë janë përfunduar dhe ka mbetë që Ekzekutivi i Komunës t'i kryej disa punë që i ka marrë përsipër në mënyrë që ato shtëpi t'iu ndahen shfrytëzuesve.

Jemi në dijeni se për ndarjen e shtëpive Kuvendi e ka ngritur në Komision i cili deri tash nuk ka shkuar në Lagjen e Dëshmorëve, mirëpo sa jam i informuar shkojnë njerëz të caktuar, flasin me banorët e lagjes dhe ju thonë unë jam për me ta dhënë ty shtëpën, lidhur me këtë unë në cilësinë e anëtarit të Komisionit kam marrë shumë telefonata dhe të gjithëve ua kam caktuar se Komisioni ende nuk është takuar dhe se ende nuk ka asgjë lidhur me ndarjen e shtëpive, mirëpo nuk kam mundur me i bind ngase përgjigjja e tyre ka qenë, zyrtarët e Komunës kanë ardhur te ne dhe ne jemi në dijeni se është duke u punuar për ndarjen e shtëpive.

z. Agron Hyseni, theksoi, një komision ka shkuar në Lagjen e Dëshmorëve për të marrë të dhënat lidhur me rregullimin e infrastrukturës që e ka marrë përsipër Komuna si dhe të dhënat për lirimin e hapësirës në të cilën do të ndërtohen shtëpitë në fazën e dytë ngase aktualisht ka hapësirë për ndërtimin e vetëm tetë shtëpive.

Komisione të tjera nga Komuna nuk kanë shkuar në Lagjen e Dëshmorëve.

- z. Haki Rudari**, theksoi, në takimin që e ka mbajtur Komisioni për ndarjen e shtëpive, zyrtari i Ministrisë së Punës dhe mirëqenies Sociale, ka thënë se 30 shtëpi janë të përfunduara, mirëpo Komuna nuk e ka kryer obligimin e vet për rregullimin e infrastrukturës, andaj Komuna duhet të përmblush obligimin e saj në mënyrë që shtëpitë t'i ndahen familjeve përkatëse në shfrytëzim.
- z. Rafet Llapashtica**, theksoi, konstruktiv i ndërtuesave ekzistuese në Lagjen e Dëshmorëve, kryesisht është i metaltë, ndërtesa të cilat mund t'i jepen ndonjë kompanie për të larguar pa ndonjë kompensim apo të shiten përmes një ankandi, kjo është çështje e Ekzekutivit, mirëpo kryesore është që të lirohet hapësira për ndërtimin e shtëpive të reja.
- z. Mynavere Abdullahu**, theksoi, nuk e kuptoj debatin kaq të gjatë lidhur me këtë çështje ngase e mira më e madhe është që banorëve të asaj lagjeje po ju bëhet zgjidhje për kushte më të mira të banimit.
- Kuvendi i Komunës e ka ngritur Komisionin për ndarjen e shtëpive dhe konsideroj se Rregullorja e propozuar i ka kriteret e përcaktuara në bazë të të cilave mund të ndahen shtëpitë pa kurrrfarë problemi.
- Sa i përket propozimit të Rregullores ne mund të debatojmë duke filluar nga nen i parë deri te nen i fundit, e nëse e vazhdojmë debatin në këtë mënyrë duke folur për Rregulloren në përgjithësi, si duket debatit nuk i shihet fundi.
- z. Naim Çunaku**, theksoi, propozimi i kësaj Rregulloreje është paraqitur për shqyrtim në këtë Komitet, andaj përgjegjësia për këtë bie në këtë Komitet e dihet edhe në Kuvend të Komunës i cili e miraton, andaj çdo njëri prej nesh mund të jep vërejtje në ndryshimin apo modifikimin e çdo nen, kuptohet propozimet konkrete vihen në votim dhe nëse mbështeten, Kuvendit i rekomandohet për shqyrtim me ndryshimet e mbështetura.
- z. Bahri Blakçori**, theksoi, dispozitat ligjore ekzistojnë, Komisioni është ngritur, tani me këtë propozim të Rregullores propozohen edhe kriteret për dhënien në shfrytëzim të shtëpive, andaj nëse anëtarët e Komisionit e kryejnë punë me përgjegjësi, atëherë gabime nuk mund të ketë.

Pas debatit, nen për nen, propozimi i kësaj Rregulloreje Kuvendit njëzëri i rekomandohet për shqyrtim me ndryshime si vijon:

- Në nenin 5 parag. 4 pikë 4 teksti “Familje në përkujdesje të fëmijëve” të zëvendësohet me tekstin “Familje me fëmijë pa prind”
- Neni 7., teksti “Në kërkesë të Komunës dhe miratimin nga ana e MPMS – së, ndonjë familjeje banuese në lagje që posedojnë troje, iu sigurohet materiali ndërtimor”, të riformulohet “Ndonjë familje e cila posedon truall, në kërkesë të Komunës dhe miratim të MPMS, i sigurohet materiali ndërtimor për ndërtimin e shtëpisë”
- Neni 8 parg. 3, teksti ‘deri në përfundim të mandatit të Kuvendit’ të zëvendësohet me tekstin “Deri në ndonjë vendim tjetër të Kuvendit”.
- Neni 10, pas tekstit “nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale” shtohet “Drejtorisë përkatëse”.

4. Propozimi i Planit vjetor të punës të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2014

Kuvendit, njëzëri i rekomandohet për shqyrtim.

5. Propozimi i Vendimit për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës – Lokal afarist

z. Abaz Llugaliu, drejtor i Drejtorisë së Pronës, Kadastrit dhe Gjeodezisë, e paraqiti fjalën hyrëse.

Kuvendit, njëzëri i rekomandohet për shqyrtim.

6. Propozimi i Vendimit për ngritjen e Komiteteve Konsultative
- Miratimi i Vendimit për publikimin e konkursit

Kuvendit, njëzëri i rekomandohet për shqyrtim.

7. Propozimi i Vendimit për zëvendësimin e një anëtari të Komisionit vlerësues për dhënien e pronave të Komunës së shfrytëzim

Kuvendit, njëzëri i rekomandohet për shqyrtim.

8. Propozimi i vendimeve për destinim të përhershëm të tokës bujqësore në tokë ndërtimore (Sipas kërkesave të Besim, Villaznim e Mustafë Ejupit – Gllamnik, Ajet Malokut – Bradash, Këshillit të Bashkësisë Islame – Podujevë, Sabit Selmanit – Gllamnik, Rexhep Cahanaç – Krajk, Zymer Duriqit – Obranqë, Armand Fejzullahut – Sallabajë, Bekim Havollit – Llapashticë e Epërme, Sabit Halilit – Podujevë dhe Fadil Bunjakut – Sallabajë).

Kuvendit, njëzëri i rekomandohet për shqyrtim.

Pas përfundimit të shqyrtimit të pikave të rendit të ditës,

z. Mehmet Gashi, theksoi, Ministria e Financave, një ditë më parë, e ka dërguar Qarkoren Buxhetore nr. 2015/1 për Komunat, sipas së cilës përveç Ekzekutivit edhe Komiteti për Politikë dhe Financa është i obliguar të organizoj takime publike me qytetarë, në këtë kontekst është planifikuar që KPF të mbaj një takim publik me qytetarë afersish me datën 13 qershor 2014, datë për të cilën mund të debatojmë por në marrëveshje të përbashkët mund të caktojmë këtë apo ndonjë datë tjeter.

z. Naim Çunaku, theksoi, zotëri kryesues i Kuvendit dhe KPF – së nëse duhet të thërrasim diçka në emër të komitetit për Politikë dhe Financa, duhet me thirr mbledhje të Komitetit që të merr vendim paraprakisht, kjo është procedura nëse doni ta respektoni, në të kundërtën vazhdoni ashtu si keni vepruar deri më tash.

z. Mehmet Gashi, kryesues, theksoi, Thirrja e takimit publik me qytetarë është obligim që del nga Qarkorja Buxhetore përkatëse e ministrisë së Financave, e neve na mbetet vetëm të caktojmë datën e takimit.

z. Naim Çunaku, theksoi, edhe në vitin e kaluar na ka përcjellë i nënji problem, është bërë shkelje çfarë është bërë, kryesues ka qenë z. Hazir Raçi, unë personalisht jam konsultuar me Departamentin Ligjor të Minsitrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, është bërë shkelje ligjore, bile dikujt, dikujt i janë bërë vërejtje por ne i kemi stopuar.

Kryesuesi i KPF – së nuk e ka të drejtën me thirr takime me qytetarë, në emër të Komitetit, ngase vetëm Komiteti ka të drejtë me marrë vendim me organizuar takim me qytetarë.

z. Mehmet Gashi, kryesues, theksoi, në faqen e shtatë të Qarkores Buxhetore 2015/1 për komunat, shkruan, “ Komiteti për Politikë dhe Financa duhet të organizoj gjithashtu takime publike për të diskutuar prioritetet dhe strategjitet para aprovimit të këtij dokumenti ” dhe shtoi, të cilin duhet përbushur në bazë të këtij akti të Ministrisë së cekur.

z. Naim Çunaku, theksoi, rendin e ditës për këtë mbledhje e kemi miratuar dhe tani nuk mund të ndryshohet, sa i përket çështjes së propozuar nga kryesuesi duhet të thirret mbledhje tjeter dhe të vendoset për çështjen e cekur.

Mbledhja përfundoi në orën 15.10 ’

Procesverbalin e mbajti
Faik Gashi

Nr. 01- 006-50510

Podujevë,

26 maj 2014

Kryesuesi i Komitetit
Mehmet Gashi